

PROF. KRISTAQ FUNDO


(1906 – 1984)

MINGA A.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Matematikës

Më 15 mars 2006 në Fakultetin e Shkencave Natyrore u zhvillua një ceremoni përkujtimore për 100-vjetorin e lindjes së Prof. Dr. Kristaq Fundos. Atë ditë, salla e madhe e Fakultetit u mbush si rrallë herë. Ndër pjesëmarrësit të binte në sy një numër i madh të moshuarish, ish maturantë të viteve 1940 e deri më 1952. Kishte ndër ta akademikë, profesorë, shkrimtarë, profesionistë të shquar të fushave të ndryshme, të gjithë nxënës të dikurshëm të profesorit. Aq e mirëpritur ishte ideja e këtij përkujtimi, aq i vetvetishëm reagimi miratues i kujtdo më të cilin u nda kjo ide, aq e madhe ishte gadishmëria e të gjithëve për të bërë diçka për atë jubile, sa do të ishte me vend të thuhej se ceremoninë nuk e bënë vetëm organizatorët, por shumë më tepër veta. Ata morën pjesë me gjithë shpirt në përgatitjet e saj për t'ia bërë nderin ashtu siç e meritonte Prof. Këqës, siç e thërrisnin me dashuri këtë matematikan, i cili dha një ndihmesë të vyer në konsolidimin shkencor të mësimdhënies së matematikë në shkollën e mesme shqiptare, dhe ishte një ndër ata që vunë gur themeli edhe në arsimin e lartë. Mbresat që ndanë pjesëmarrësit në ceremoni për profesorin kishin një tis ndjesish të çiltëra, prekëse, gati sublime.

Jeta e Prof. Fundos rrodhi në një shtrat pa përthyerje befasuese, nga ato që në biografinë e njerëzve sjellin gjëra pikante, ngacmuese për kërshërinë. Por në qoftë se ajo ishte e zakonshme, veprimtaria e tij iu përgjigj më së miri detyrave që shtronte koha për zgjidhje dhe e renditi ndër ata që lanë gjurmë, të cilat nuk i mbulon pluhuri i viteve dhe nuk i gërryen plugu i pamëshirshëm i harresës të së rëndomtës. Kristaq Fundoja e nisi këtë veprimtari në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar, që në historinë e gjatë të kombit tonë shënojnë një segment të shkurtër kohor, por të



veçantë dhe mjaft interesant.

Ishte një periudhë kur shteti i ri shqiptar hidhte hapa drejt konsolidimit të tij. Duheshin shkundur gjymtyrët e kombit, të mpira nga shekuj sundimi të huaj. Duhej luftuar kundër mendësisë anadollake, të ushqyer nga memurët e vjetër të një perandorie, e cila prej kohësh, para se ta flaknim zgjedhën e saj, dergjej në shtratin e lëngatës së një amullie të frikshme. Kërkoheshin ritme të tjera përparimi për të zbutur sado pak prapambetjen me përmasa humnerore. Vendi ynë, që gjeografikisht i takonte Evropës, duhej dhe shpirtërisht e kulturalisht të rivendoste hap pas hapi sistemin e lidhjeve me të, të këputur dhunshëm e të gjymtuar rëndshëm. Rilindësit e mënçur ishin të vetëdijshëm se drita për të davaritur terrin shekullor, do të vinte andej nga perëndon. Ishin sfida të vështira, por, si rregull, kur lind një nevojë e ngutshme shoqërore, krijohen paralelisht edhe kushte që të dalin bartës historikë të kënaqjes së saj. Eshtë fakt që në vitet 1930 doli në paraskenën e historisë sonë një grup intelektualësh, në veprimtarinë e të cilëve u përthye kjo problematikë e mprehtë që zëmë në gojë më lart, si në mënyrë më të përgjithshme, si në sektorë më të veçantë. Kjo gjeneratë intelektualësh është interesante dhe kam bindjen se ka për të tërhequr gjithmonë vëmendjen e studjuesve. Për disa syresh filli i jetës u këput shpejt e në mënyrë tragjike. Një pjesë pati më tepër fat dhe u kursye në travajet e rrebesheve të mëvonshme, duke vazhduar të ndihmojë në përparimin e vendit. Kësaj pjese të dytë i përket dhe Prof. Kristaq Fundoja.

Në formimin e tij, si në formimin e çdo njeriu, ndikim të fortë për mirë kanë pasur edhe disa rrethana të jashtme. Kristaqi lindi dhe u rrit në Korçë. Korça e atëhershme, pa dyshim, ishte një ndër qytetet më të emancipuara të vendit. Ajo u bë djep i lëvizjes për çlirim kombëtar, edhe për faktin se populli i kësaj treve ishte i vetëdijshëm se një ndër armët më efikase, ishte përpjekja për shkollën shqipe, për shndërrimin e saj në një farkë të dijes, të ndërgjegjes e të identitetit tonë kombëtar. Krahinë që njerëzit e saj kishin rrahur më shumë se të tjerët rrugët e kurbeteve, e kërkonte më me etje përparimin, që kombet e tjera e kishin arritur. Puna dhe dija çmoheshin, dhe në shkallën aksiologjike të korçarëve zinin vendin që meritonin.

Për fat në Korçë, qysh më 1917 ishte hapur Liceu francez. Nga fillimi i viteve njëzet, ai ishte tanimë një institucion i konsoliduar, që në hierarkinë e padeklaruar të shkollave, po zinte një vend kreu dhe po rriste për vit e më shumë reputacionin e vet. Pikërisht në këto vite Kristaq Fundoja filloi studimet e mesme në këtë lice, të cilat i përfundoi me sukses në vitin 1930. Ai fitoi një kulturë të përgjithshme solide në të gjitha disiplinat, që zhvilloheshin sipas programesh ndër më të përparuat e kohës. Por mbi të gjitha kjo shkollë

kultivonte te të rinjtë pranimin si të natyrshëm të një standardi kërkesash të larta, disiplinën shkencore në studim, pavarësinë në të menduarit e në gjykimin kritik. Në këtë shkollë Kristaqi i ri u shqua si nxënës me prirje në shkencat e përpikta, dhe sidomos në matematikë. Ai e ndjente së brendshmi bukurinë e saj, dhe në një bisedë të shumë viteve më vonë, në fillim të 1970-ës është shprehur kështu: *-Më pëlqenin sidomos ushtrimet e problemet e gjeometrisë. Nuk e nisja kurrë zgjidhjen, duke provuar kuturu. Mendoja të kapja idenë e saj të fshehur. Ajo duhej të ishte e thjeshtë dhe e bukur. Në fillim mundohesha më shumë sa e zbuloja, pastaj, me stërvitje, e arrija më shpejt. Dhe isha në gjendje të parashikojta si ta realizoja. E ndjeja se zgjidhjen e kisha në dorë; hapat e tjerë vinin vetëvetiu e pa ndonjë sforcim mendor.*

Bukurinë e matematikës K. Fundoja do ta ndiente më thellë gjatë periudhës së studimeve të larta në Universitetin e Monpeliës në Francë. Ai, siç thoshte vetë, pati vetëm një ngurrim të vogël: të zgjidhte matematikën apo ndonjë degë inxhinierike? Pasioni, që tanimë ishte ndezur në shpirtin e tij, nuk u la hapësirë llogaritjeve të ftohta me karakter më utilitar për leverdinë e 'profesioneve me bukë', që bëheshin edhe në mjedisin rrethues.

Franca, ndonëse në shekullin e 20-të, kishte rivale të forta në arenën shkencore, vazhdonte të ruante një vend nderi në elitën matematike botërore. Institucionet e saj të arsimit të lartë të specializuar matematik, si të metropolitit, ashtu dhe të qendrave më periferike u përmbaheshin standardeve më të larta të nivelit të trajtimit shkencor të programeve të përzgjedhura me kujdes. Formimi që sigurohej në to i kishte kthyer në qendra ndër më joshëset të pelegrinazhit shkencor të të rinjve të talentuar që rrekeshin të bënin emër në matematikë. Fundoja dijti të përfitonte nga mundësitë që ofroheshin dhe falë një pune këmbëngulëse e studimi sistematik përvetësoi një kulturë solide matematike. Dhuntitë e natyrshme të tij, për hir të ushtrimit të vazhdueshëm të mekanizmave të punës së mirëfilltë intelektuale e krijuese, u shpalosën e ranë në sy. Mprehtësia e intuitës së Fundos, ndoshta një nga tiparet më karakterizuese të talentit të tij matematik, i befasonte bashkëstudentët.

Pas përfundimit të suksesshëm të ciklit të studimeve universitare matematike dhe marrjes së Licencës brenda një afati më të shkurtër se periudha normale, Kristaq Fundos i lindi dëshira për të plotësuar edhe studimet inxhinierike. Nuk ishte thjesht diçka që e bënte 'për të mos i mbetur merak' edhe plotësimi i një dëshire që e pat vënë në mëdyshje për pak kohë kur ishte çasti për të zgjedhur. Jo. Kristaqi i ri ishte një djalë që jo vetëm i punonte mendja, por edhe i zinte dora. Madje, për pak muaj, para se të nisej për në Francë, kishte ushtruar 'profesionin' e mekanikut dhe, siç e pat përmendur një herë si me shaka 'ishte ngrënë me hekurat'. Dhe ndjente kënaqësi të vërtetë kur nxirrte duarsh diçka

të sajuar me merak. Është kjo arsyeja që zgjodhi Inxhinierinë Mekanike. Detyrimet që lidheshin me formimin bazë teorik inxhinierik, në një masë të madhe i konsideroheshin të shlyera. Kultura matematike e fizike e fituar e lejonte të orientohej shpejt e me lehtësi edhe në disiplinat e specialitetit, prandaj Kristaqi e siguroi edhe diplomën e Inxhinierit Mekanik.

Nuk e marrim dot me mend a ka pasur ndonjë 'dramë të vogël' mëdyshjeje Kristaq Fundoja se cilit profesion do t'i përkushtohej. Fjalëpakët siç ish, këtë 'dramë', edhe në e pastë pasur, nuk e ka zënë në gojë kurrë. Sidoqoftë, ajo do të jetë zgjidhur shpejt, sepse ai pranoi, pas kthimit nga Franca, të fillonte punën më 1936 në Gjimnazin e Gjirokastrës. Aty nuk qëndroi gjatë, por edhe në pak kohë ai la mbresa për dijet dhe horizontin e tij matematik. Më 1972, kur ra fjala për Fundon, Javer Maloja, ish nxënës i atëhershëm i tij, më pat thënë: *-Ndonëse pa përvojë, e në kërkim të mjeshtërisë pedagogjike që i mungonte, ne e kuptonim se ai ishte shumë i zoti, kishte stofin e një matematicieni të vërtetë.* Nxënësit rrallë gabojnë në vlerësimet e tyre dhe duket sikur kanë një 'shqisë' të veçantë perceptimi e zbulimi të tipareve të mësuesit nëpërmjet tistit të dukshëm e të padukshëm të komunikimit me ta.

Kristaq Fundoja shumë shpejt do të meritonte reputacionin e një prej mësuesve më të mirë të matematikës të një shkolle të dëgjuar si Liceu i Korçës, ku u transferua dhe ku për gati 15 vjet, me ndonjë ndërprerje të vogël, zhvilloi një veprimtari të frytshme e të suksesshme. Pa dyshim, duke qenë i tillë, emri i tij përmendej me nderim e respekt të veçantë edhe në mjediset arsimore në shkallë vendi.

Në qoftë se do të donim të kërkonim ndonjë tipar karakterizues të profesorit të ri, do të ishim të saktë po të veçonim pasionin e tij të jashtëzakonshëm për matematikën. Ai ishte aq i thellë, aq frymëzues sa dukej sikur i buronte nga thelbi i qënies dhe kushtëzonte tërë ritmin e jetës së tij. Atë e ripërtërinte fuqishëm një punë e përditshme zbulimi të hireve të mistershme të kësaj shkence, që i sillte përjetime kënaqësish që rrallëkush i ka provuar si Kristaq Fundoja. Këtë pasion nuk ia zbehën vitet, dhe kush dinte 't'ia kuptonte', ia shihte në përshkënditjen e veçantë të syve, tek e kënaqte diçka e hedhur në letër shpejt e shpejt pas një përumbjeje meditimi edhe në moshë të kaluar. Në shkollë, brenda kufijve të programeve, gjente hapësirë për trajtime origjinale, të parashtruara me një stil lakonik, me formulime të qarta e të përpikta. Ai qëmtonte gjërat më të goditura që i pëlqenin në ushtrimet e problemet e sajuara nga autorë të librave të shumtë, që shfletonte, por ishte edhe vetë krijues. Dinte ta nuhaste të bukurën, interesanten, befasuesen dhe vlerësonte së tepërmi elegancën e zgjidhjeve. Ndodhte që në klasë, tek zgjidhte vetë a ndonjë nxënës në dërrasën e zezë ushtrimit, thoshte *-Dale,dale...*, puliste për

një çast sytë, sikur ia vriste drita e beftë e një ideje të re, që merrte udhë me nxitjen *-Pa ta provojmë ndryshe...* Dhe hap pas hapi përvijohet një rrugë më e shkurtër, më e drejtpërdrejtë, shumë më e bukur zgjidhjeje.

Jam i sigurt që Fundoja nuk kishte lexuar ndonjë shkrim të George Polya-s, didaktit të madh të matematikës, sepse nuk ka shfaqur interes për didaktikën. Mjeshtri i madh dhe i paarritshëm Polya në një artikull për artin e mësimdhënies, një nga këshillat që u jepte mësuesve të matematikës ishte edhe kjo: *-Ju e dini si rrjedh shtjellimi i mëtejshëm, ju e dini zgjidhjen e problemit dhe hapat që çojnë drejt saj. 'Improvizimi' i saj në sy të nxënësve të mbresa dhe formon më shumë sesa paraqitja më e paqortueshme, por e ftohtë dhe sistematike e saj. Mësuesi duhet të jetë pak 'aktor'. Bëni sikur nuk e njihni zgjidhjen, sikur po e kërkon, rrekuni sikur hetoni, provoni, skartoni e riprovoni shtigjet që do të ndiqni. Po arritët të dukeni të natyrshëm në këtë proces, suksesin e keni të sigurt. Nxitja e të menduarit, bashkëpjesmarrja e nxënësve në një humultim joshës të së panjohurës, sjell fryte të mrekullueshme në mësimin e matematikës.* Fundoja e paska ndjekur këtë këshillë të Polyas, pa e ditur. Ai 'improvizonte' në mësim, por kam bindjen asnjëherë si 'aktor'. Parashtrimi i një problemi, natyrisht jo të rëndomtë, ishte si sinjali i një refleksi të kushtëzuar meditimi e rimeditimi. Pra, nuk ishte 'sjellje aktorese', por një natyrë e dytë e profesorit tonë. Ai u bë jo vetëm ikonë e liceut, e pastaj gjimnazit 'Raqi Qirinxhi', por u shndërrua edhe në një prej figurave emblematike të Korçës, gjerësisht i njohur ndër banorët e qytetit për namin e tij, i respektuar për korrektesën, i admiruar për pasionin.

Kërkues ndaj vetes, deri në kufijtë e rreptësisë së skajme, ai kishte të drejtën morale të ishte kërkues edhe ndaj të tjerëve. Ndonjëherë kjo i etiketohej si tepri dhe me kalimin e viteve u zbut disi, por mbeti larg lëshimeve sado të vogla me të cilat s'mund të pajtohej, qoftë edhe i vënë nën një farë trysnie, në fillim të viteve 1950-të.

Profesor K. Fundoja sa punoi në lice e gjimnaz kaloi 'nëpër duar' breza të tërë nxënësish, me merakun që ata të fitonin një kulturë të përgjithshme matematike, të mirë e me baza të shëndosha. Dhe çfarë standardesh arriti e dëshmojnë mjaft fakte kuptimplota, nga të cilat do të veçoja ndonjë. Nga viti 1946 e më pas mjaft maturantë të Korçës, ish nxënës të Këçkës, ndoqën studimet universitare jashtë shtetit, në vendet e Evropës Lindore e Qendrore, të ashtuquajtura të demokracisë popullore, shumë syresh për t'u përgatitur si specialistë në profesione, që kanë kërkesa të larta për formim matematik e njohuri të gjera e të thelluara në këtë fushë. Të gjithë, që kishin provuar 'mengenë' e Fundos, u dukeshin provimet universitare matematike një sprovë relativisht më e lehtë në krahasim me detyrimet e tjera, dhe kjo,

natyrisht, falë përgatitjes që kishin. Provuesve u bënin përshtypje njohuritë e tyre dhe e shfaqnin edhe haptas kërshtërinë për këtë nivel. Po i lejoj vetes të sjell një dëshmi autentike të një rasti, përcjellësi i së cilës kam qenë në shkurtin e largët të vitit 1952. Një bashkënxënës i maturës së vitit 1952 (ai tani nuk rron më) vazhdonte studimet për Inxhinieri Mekanike në Moskë. Profesi i tij i matematikës, duke parë lehtësinë me të cilën i zgjidhte problemet e analizës matematike, por sidomos të gjeometrisë analitike, e pyeti çfarë shkolle kishte mbaruar. Ai i pat folur për të, por nuk harroi të përmendte edhe profesor Këçkën dhe t'i tregonte edhe një fletore detyrash të matematikës, që e kishte marrë nga Shqipëria, se mbase i hynte në punë. Moskoviti e shfletoi dhe u befasua. *-Do të doja ta përgëzoja mësuesin tuaj!* Pas dy ditësh i sjell një letër të shkurtër, të shkruar me dorën e tij dhe i lutet të gjejë mundësinë për t'ia përcjellë Prof. Fundos. Meqë shoku im dinte vetëm adresën time e dërgoi tek unë, atëherë student i vitit të parë në degën e matematikës, për t'ia dhënë profesorit, që ndërkohë ishte transferuar në Tiranë. Letra ishte shkruar në rusisht dhe Fundoja nuk e njihte këtë gjuhë. M'u desh t'ia përktheja unë, me aq sa merrja vesh. Thelbin e saj e rroka, ndërsa nuancat jo dhe aq mirë dhe për to m'u desh të interpoloja me intuitë. Mbaj mend vetëm që përfundonte me fjalën *POZDRAVLJAJU!*, të shkruar me shkronja të mëdha. U ndjeva krenar për profesorin tonë dhe ndoshta shtova edhe nga vetja në interpolimin, por më falej se i ndieja sinqerisht. Fundoja u prek, palosi letrën dhe e futi në xhep. Ishte një nga rastet e rralla kur e kam parë të emocionuar. Letra vinte si një dëshmi e bukur, joformale, në mbyllje të një pjese të karrierës së tij, sepse ajo tanimë kishte hyrë në një cikël të ri të saj.

Më 1951 u ngritën Institutet e para të studimeve të plota të larta. Nevojë e mprehtë ishte plotësimi i trupave të tyre pedagogjike dhe shkencore. Shumicën e tyre po e përbënin specialistë të rinj që sa kishin mbaruar studimet jashtë shtetit. Por nuk do të shpërfillej edhe ai potencial intelektual ekzistues, sidomos në fushat e shkencave teknike e natyrore. Emri i Kristaq Fundos nuk mund të mos merrej në konsideratë, sepse ai ishte një nga mësuesit më të përgatitur dhe të suksesshëm të matematikës.

Në këtë mënyrë, në vitin akademik 1952-53 Prof. Fundoja filloi punën si pedagog në Institutin Politeknik. Nga koha e diplomimit të tij kishin kaluar më shumë se 17 vjet dhe një shkëputje e tillë krijon vështirësi për të përballuar mësimdhënien në shkollën e lartë, jo vetëm se koha i zbeh njohuritë e fituara dhe i dobëson shprehitë e nevojshme, por edhe sepse përparimi matematik është i vrullshëm dhe arsimit i lartë është më i hapur për një pasqyrim më të shpejtë të tij. Por K. Fundoja nuk i kishte mbyllur librat me mbarimin e

universitetit. Përkundrazi, ai e kishte një kënaqësi të përditshme shfletimin e tyre, përpjekjen për të provuar forcat me sfidën e ndonjë problemi të vështirë, orvatjet për të kërkuar shtjellime të reja në raport me ato të paraqitura në tekste. Nuk mund të themi se ai i ndiqte arritjet matematike me interesa kërkimore dhe as i kishte kushtet minimale për ta bërë një gjë të tillë në Shqipërinë e asaj kohe. Megjithatë, i pasionuar siç ishte ndaj matematikës, duke lexuar e duke u ushtruar vazhdimisht, e mbante të freskët intelektin e tij, nuk linte të mpiheshin e të veniteshin ato cilësi të intuitës dhe të të menduarit të tij, që e lejonin të orientohej e të gjente rrugën e duhur në meandrat e problematikës matematike. Për këto arsye, Fundoja nuk u trembej vështirësive, kur nisi karrierën e re universitare në një moshë 46-vjeçare. Dhe këtë sfidë jo të lehtë e përballoi me dinjitet e me faqe të bardhë.

Me gjithë ngarkesën e lartë mësimore në auditor, merrte pjesë gjallërisht në diskutimin, rishikimin dhe plotësimin e programeve, në krijimin e një ushtrimoteke të përshtatshme. Mendimet e tij dëgjoheshin dhe vlerësoheshin në Katedrën e Matematikës, Fizikës dhe të Mekanikës teorike në të cilën bënte pjesë. Fundoja i takon asaj plejade që vuri gurët e themelit të bazave teorike të formimit inxhinierik të ne, dhe ndihmoi në krijimin e një tradite të shëndoshë të përgatitjes matematike të inteligjencies së re teknike në vendin tonë. Njohja e matematikës, por edhe e disiplinave inxhinierike, falë diplomimit të tij të dyfishtë, i bënte më të besueshme argumentimet që paraqiste në rrahjet e shumta të mendimeve për këto çështje në ato vite. Kulturën matematike të Fundos e vlerësoi edhe profesor Sokolovi, profesionist i zoti e me përvojë të madhe, lektor i shkëlqyer i matematikës dhe i mekanikës teorike. *Profesor Fundos – pat thënë ai - mund t'i besohet plotësisht matematika në Institutin Politeknik, sepse i ka të gjitha kapacitetet për ta marrë përsipër këtë detyrë. I çmoj kulturën dhe aftësitë e tij, përkushtimin në punë dhe jam i kënaqur që e kam pasur dhe e kam në krah në Institut.* Këtë opinion dhe rekomandim Prof. Sokolovi ua pati paraqitur me shkrim dhe më hollësisht edhe organeve të interesuara. Një njeri i mprehtë si Prof. Sokolovi ishte tepër i saktë në gjykimin e tij.

Më 1957, me themelimin e Universitetit të Tiranës, u krijua edhe Katedra e Matematikës. Prof. Fundoja ishte anëtar i saj, tanimë koleg me disa ish nxënës të tij, ndër të cilët dhe shefi i katedrës, Prof. Petraq Pilika. Filloi atëherë një punë shumë intensive për kualifikim më të thelluar shkencor, për zgjerimin e spektrit të kulturës matematike në disiplina bashkëkohore me perspektivë të qartë zhvillimi.

Korrekt si gjithmonë, Prof. Fundoja, u përgjigjej këtyre detyrimeve dhe përpiquej të ecte me hapin e kohës. Moshë nuk e lejonte t'i kushtohej kërkimit

shkencor në ndonjë prej drejtimeve të reja, ku po përqëndroheshin forcat tona të pakta në numër. Por Fundoja ndiehej mirë në fushën që emërtohej me emrin konvencional matematikë elementare, ku epiteti nuk ka të bëjë me thjeshtësinë, por me karakterin bazal të disiplinave me historinë më të lashtë në matematikë. Ajo mbetet një zonë gjetjesh interesante, ku përdoret një arsenal mjetesh që pasurohet e ripertërihet vazhdimisht në ndikimin e arritjeve bashkëkohore edhe në degëzime të reja. Profesor Fundoja pranoi me gatishmëri shembullore, të mbulonte disiplinat themelore matematike të Institutit dyvjeçar, por duke mbetur anëtar efektiv i Katedrës së Matematikës të FSHN-së. Për disa vite, derisa Instituti u mbyll. Prof. Fundoja ishte figurë qendrore e degës së matematikës e të fizikës në IP-në e Tiranës. Si titullar lëndësh kryesore e rriti nivelin shkencor të trajtimit të tyre, çka u pasqyrua edhe në tekstet bazë që hartoi për to, të cilat u përdorën për një kohë edhe në Institutet e tjera pedagogjike. I dhënë sidomos pas ushtrimeve, kërkonte, por sajonte edhe vetë probleme të bukura, të një shkalle jo të vogël vështirësish, të cilat ua jepte studentëve të dalluar dhe i nxiste të merreshin me to.

Duke pasur ngarkesën kryesore mësimore në Institut, jetën shkencore e bënte në Katedrën e Matematikës. Më 1972, kur u bë riorganizimi i veprimtarisë shkencore dhe u krijuan grupet e profilizuara, në përputhje me stadin e ri të arritur, Prof. Kristaq Fundoja zgjodhi grupin e gjeometrisë. Ky grup punonte me ritme të larta dhe u bë shembull për grupet e tjera. Ai e formoi shpejt fizionominë e vet dhe përcakttoi drejtimit bazë të interesimeve shkencore. Ndonëse i shtyrë në moshë, Fundoja ishte mjaft aktiv, në shqyrtimin e diskutimin e problematikave të trajtuara në seminaret. E kënaqnin së tepërmi arritjet e më të rinjve dhe entuziazmohej nga horizontet e reja që po hapeshin edhe për kërkimin tonë gjeometrik. Punoi edhe vetë për një trajtesë origjinale, duke e marrë shtyrjen nga një prirje bashkëkohore integrimi ndërdisiplinor. Dora-dorës që përparonte, i paraqiste rezultatet e arritura në grup. E shkruar me merak, trajtesa e gjerë 'Zbatimi i numrave kompleksë në zgjidhjen e problemeve gjeometrike' u botua si një punim i veçantë në trajtë dispence. Ishte kënga e fundit e mjellmës, por një këngë e bukur, siç janë ato të dala nga shpirti. Tregohej në këtë trajtesë forca e aparatit analitik të numrave kompleksë për zgjidhjen e shpejtë të një game të gjerë problemesh gjeometrike. Ideja ishte realizuar me mjaft mjeshtëri e me elegancë. Punimi ishte një variacion tepër i qëlluar i një teme të njohur, që tingëllonte si diçka e freskët e mbresëlënëse. Në këtë vështrim, matematika është një minierë e pashtershme. Fundoja, ky gërmues i palodhur në galeritë e saj, gëzohej si fëmija kur i shpërblehej munda me gjetje që e kënaqnin si rrallëkënd.

Më 1 tetor 1982 Prof. Kristaqi doli në pension, pas plot 46 vjete pune. Në vitet 1950-51 dhe 1951-52, kur e pata mësues në gjimnazin 'Raqi Qirinxhi', nuk e

mbaj mend të ketë munguar qoftë edhe njëherë në një orë mësimi. Për të çdo detyrim që lidhej me shkollën ishte i shenjtë. Nuk do ta harroj një rast të cilin po e përmend edhe këtu. Në mëngjesin e një të diele, troket në shtëpinë time: *-Leko – më thotë – sot është ditë pushimi dhe nuk kam mundësi të njoftoj njeri në fakultet. Nesër kam provim me studentët e vitit të parë të matematikës, por ndoshta nuk do të vij dot, prandaj të lutem lajmëro ku duhet, për ta shtyrë provimin një ditë. Thuaju edhe studentëve. Ka vdekur Borisi, im kumat, por e ka lënë me gojë ta varrosin në fshatin e tij të lindjes, në Boboshticë. Patjetër do t'ja plotësoj amanetin, se ai bashkë me motrën time, prandaj u kthyen pas një jete të tërë të kaluar në Rumani.* Pas ngushëllimeve të rastit iu ofrova për t'a ndihmuar, duke njoftuar edhe ndonjë koleg tjetër, meqë ishte i vetëm. *-Jo, jo, të falemnderit – u përgjigj – pak gjë ka mbetur; ja po pres të vijë makina e do të nisem për Boboshticë, bashkë me trupin e të ndjerit.* Kush i ishte gjendur në ato çastë për ta ndihmuar? Nuk e di. Di që e kishte gdhirë tërë natën, kishte shkuar edhe vetë nëpër zyrat për formalitetet, por siç ndodhte jo rrallë, makina u vonua dhe u nisën pasdite vonë. Mbërritën rreth orës 9 të mbrëmjes në fshat. Vetë profesori, me shoferin e me ndonjë tjetër, e mbuluan të ndjerin. Të nesërmen, ku shkova në fakultet, para derës së sallës ku do të merrte provim Prof. Fundoja, pashë një grup studentësh. *-Mos e prisni profesorin, se provimi është shtyrë për nesër. -Profesorin e ka filluar provimin – m'u përgjigjën të habitur. -Gjashtë të parët kanë një çerek ore që kanë hyrë.* Shtanga. Siç më tha kur e takova në sallë, kishte udhëtuar tërë natën, ishte kthyer në shtëpi vetëm për t'u rruar dhe kishte ardhur në fakultet para orës 8. Dy netë pa gjumë, duke përballur strese jo të vogla psikike dhe fizike, 72-vjeçari Fundo nuk ia lejonte vetes të mos ishte korrekt në detyrë, deri në kufijtë e së papërfytyrueshmes.

Duke folur për Prof. Fundon do të doja të zbuloja edhe ndonjë tipar të tij në rrafshin e marrëdhënieve njerëzore. Duke qenë tip introvert, ai nuk i shfaqte së jashtmi ndjenjat e tij. Shumëkush mendonte se matematika, ashtu siç ishte ai i përthithur me gjithë shpirt pas saj, e mbushte tërësisht botën e tij të brendshme, pa lënë hapësirë për ndjesi e përjetime të tjera.

Kush e ka njohur nga afër Kristaqin nuk mund të mos i ketë lënë mbresë të thellë dashuria e tij për nënën. Ai e adhuronte atë. E shikonte në dritën e syrit për t'i lexuar çdo dëshirë e për t'ja plotësuar. Nuk dinte t'i thonte fjalë të bukura, por nëna e ndjente me zemrën e saj përkëdhelinë e tij. Në dhjetë minutat e pushimit shpesh e bënte me vrap rrugën fakultet-shtëpi për ta parë e për t'i çuar diçka. E merrte në krahë trupin e saj të imët, për ta zbritur nga shkallët kur u moshua dhe për ta shetituar me karrocë në rrugët e Tiranës. E çonte në kishë, se dëshira e nënës ishte ligj, pavarësisht se kjo nuk shihej më

sy të mirë. Ndoshta një nga arsytet që Prof. Fundoja nuk krijoi familje të vetën, ishte edhe merakë se mos nënën bashkëshortja nuk do t'ja deshte me atë përgjërimit siç e desh ai.

Kristaqi e quante mirënjohjen një gjë sublime dhe dinte ta shprehte atë deri në kufijtë e sakrificës. Kur ishte për studime në Francë, nuk kishte bursë shtetërore. Kristaqin e ndihmonte materialisht burri i motrës, Dhimitraq Bimbli, dhe ai këtë nuk ia harroi kurrë. Qëlloi, që pas luftës, familja e së motrës ishte keq ekonomikisht dhe Kristaqi bënte çmos që asaj të mos i mungonte gjë. Kur u transferua në Tiranë, vështirësitë u rritën se duheshin mbajtur dy familje. Pas vdekjes së nënës, Fundoja bënte një jetë spartane dhe pjesën më të madhe të të ardhurave e çonte në Korçë. Gjithnjë do të gjente rast t'u çonte me ish nxënës, studentë a të njohur të tjerë, veç parave, edhe ushqime. Dhe nuk e kemi dëgjuar njëherë ta zinte në gojë këtë që bënte. Shpirti i tij, ne dukje hermetik, kishte një dritë fisnikërie të vërtetë.

Prof. Kristaq Fundoja për punën e tij mori një vlerësim plotësisht të merituar. Ai ishte dekoruar me medalje pune, ndërsa në 1977-të, në njëzet vjetorin e themelimit të UT-së iu akordua Urdhri Naim Frashëri i Klasit të Parë. Në fillim të viteve 1960 iu dha grada shkencore Kandidat i Shkencave Matematike, tani e ekuivalentuar me atë të Doktorit të Shkencave, si edhe titulli Docent. Më 1972, për veprimtari të shquar pedagogjike-shkencore iu dha titulli Profesor. K Fundoja ishte ndër të parët që u nderua me titullin Mësues i Merituar, ndërsa me 1992, pas vdekjes, Presidenti i Republikës i akordoi titullin Mësues i Popullit. Në to materializohej në mënyrë simbolike respekti, nderimi dhe mirënjohja që patën dhe vazhdojnë të kenë për të breza e breza të tërë nxënësish e studentësh, të cilët patën fatin ta kishin Prof. Fundon mësues e pedagog, dhe t'ia çmonin pasionin e zjarrtë për matematikën, zotësinë në këtë fushë të rëndësishme të shkencave, përkushtimin deri në harrim të vetvetes, për t'u dhënë njohuri të shëndosha e të qëndrueshme. Këtë respekt e nderim e bëri edhe njëherë shumë të prekshëm përkujtimi i 100-vjetorit të lindjes së tij.

Do të doja ta mbyllja këtë shkrim me një ndodhi me simbolikë domethënëse. Prof. Fundoja nuk krijoi familje, por ai e pati një familje të madhe, jo thjesht në kuptimin e figurativ, por edhe në kuptimin më të mirëfilltë po të kihen parasysh ndjenjat njerëzore që ushqenin për të ata që patën fatin të mësonin prej tij. Do të ishte një akt i natyrshëm dhe në nderin e kësaj 'familjeje' të kujdesej të ndërtohej një monument mortor i denjë për prehjen e përjetshme të Profesorit. Prandaj propozimit përkatës që u bë në ceremoninë e 100-vjetorit u prit me miratim të njëzëshëm. Në më pak se tri javë, me kontributet që u

mblodhën ky monument iu ngrit. Mbi pllakën e mermertë janë shkruar fjalët e thjeshta, por të dal nga zemra *‘Në shenjë mirënjohje, nderimi e respekti – ish nxënësit, studentët, kolegët’*. Një mbishkrim mbresëlënës ky. Ndoshta ai ka ndikuar në diçka që më vjen mirë ta përmend: Po të shkosh te kjo përkujtimore, nuk do të gjesh më pluhur; duar të panjohurish e pastrojnë herë pas here. Me sa duket në zemra fisnike shqiptarësh ruhet ende ndjenja e respekti për Mësuesin, këtë pishtar të dijes.